



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**TIRANË**

---

**Nr. 658 Akti**

**V E N D I M**  
**CAKTIM MASE SIGURIMI**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga :

**ANTONELA PRENDI - GJYQTARE**

asistuar nga sekretare gjyqesore Dila Doçi, sot ne 21.04.2016 mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore, kerkesen penale me Nr. Akti 658 qe i perket :

**K E R K U E S:**

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, perfaqesuar nga prokurori Ndini Tavani.

**O B J E K T I:**

Caktim i mases se sigurimit pasuror duke urdheruar sekuestrimin e shumave ne euro dhe ne leke te ndodhura ne llogarine e subjektit S... A...a sh.p.k me NIPT L5...T ne Banken e Tiranes sh.a dhe te gjitha llogarite e ketij subjekti ne bankat e nivelit te dyte te RSH.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 228, 229, 274 te K Pr Penale.

Ne konkluzionet perfundimtare:

**Prokurori** kerkoj pranimin e kerkeses. Sekuestrimin e shumes ne euro dhe ne leke te ndodhur ne llogarine e subjektit S... A... sh.p.k me NIPT L5...T ne Banken e Tiranes sh.a dhe te gjitha llogarite e ketij subjekti ne bankat e nivelit te dyte te RSH.

**Gjykata** pasi degjoi diskutimet perfundimtare, deklaroi te mbyllur shqyrtimin gjyqesor dhe si çmoi provat ne teresi

## **VEREN**

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ka paraqitur per gjykim kerkesen penale me objekt *“Caktim i mases se sigurimit pasuror duke urdheruar sekuestrimin e shumave ne euro dhe ne leke te ndodhur ne llogarine e subjektit S... A... sh.p.k me NIPT L5...T ne Banken e Tiranës sh.a dhe te gjitha llogarite e ketij subjekti ne bankat e nivelit te dyte te RSH “*

Nga analiza e provave te lejuara per shqyrtim rezultoi se :

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ka rregjistruar procedimin penal nr. 2226/2016 per vepren penale te *"Pastrimit te produkteve te vepres penale ose aktiviteteve kriminale"* parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Me dt 02.09.2015 eshte rregjistruar shoqeria *“S... A...”* sh.p.k ( NIPT L5...T) me ortak shtetasit A. T. dhe P. C. ( dt 25.06.1978) me 50 % te aksioneve secili dhe administratore shtetasen B. G. referuar te dhenave te Qendres Kombetare te Rregjistrimit. Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte kryerja e cdo aktiviteti te ligjshem ne lidhje me tregetimin dhe perpunimin e arit dhe nenprodukteve te tij perfshi, por pa u kufizuar, ne blerjen, shitjen, transferimin, transformimin, disponimin, posedimin e tij etj. Kjo shoqeri e ka qendren ne Tirane, rruga *“...”*, pallati 17, hyrja 3, ap 12.

Nga provat e siguruara deri ne fazen aktuale te hetimeve paraprake rezulton se ne llogari te subjektit tregetar *“S... A...”* sh.p.k jane depozituar ne vazhdimesi shuma te konsiderueshme monetare, te cilat sipas faturave rezultojne se kane lidhje me shitje te floririt nga kjo shoqeri, kryesisht te subjekti E... P... srl Itali. Shumat e depozituara per llogari te shoqerise S... A... sh.p.k prane Tirana Bank sha nga subjekti E... P... srl Itali per periudhen shkurt 2006 – prill 2006 rezultojne 561 644 Euro. Me dt 07.04.2016 konstatohet se prane te njejtës banke eshte transferuar shuma 190 000 euro nga

ana e subjektit S... D... 2015 D... Maqedoni, me te njejtin pershkrim, shitje floriri nga subjekti S... A...

Gjate hetimeve paraprake eshte administruar informacioni nga misioni Interforce Itali sipas te cilit ortaket e subjektit S... A... sh.p.k jane persona te sinjalizuar per perfshirje ne aktivitete kriminale, kryesisht vepra penale te marrjes se prones ne menyre te paligjshme.

Sipas kontrates per shitjen e kapitalit dt 20.10.2015 rezulton se ortak i ri i shoqerise S... A... sh.p.k eshte bere shtetasi Italian D. P., i cili ka blere rreth 30 % te kapitalit. Sipas informacionit policor rezulton se ky shtetas italian eshte pjese e grupit kriminal Ndrageta Itali. Referuar te dhenave te Drejtorise Vendore te Policise gjendja e llogarive te shoqerise S... A... sh.p.k prane Tirana Bank sh.a eshte 141 822 Euro dhe 53 008 leke.

Sa me siper sipas organit te akuzes krijohen dyshime se pasurite ( mjete monetare) te shoqerise S... A... sh.p.k jane produkt i aktiviteteve kriminale dhe disponimi i lire i tyre mund te rendoje pasojat e vepres penale te *"Pastrimit te produkteve te vepres penale ose aktiviteteve kriminale"*. Per kete arsye kerkohet vendosja e sekuestros preventive mbi llogarite bankare te shoqerise S... A... sh.p.k prane Tirana Bank sh.a dhe ne cdo banke te nivelit te dyte ne RSH konform nenit 274/2 te KPrP me qellim pengimin e disponimi te lire mjeteve monetare, fakt qe mund te zjaste ose rendonte pasojat e vepres penale te *"Pastrimit te produkteve te vepres penale ose aktiviteteve kriminale"* qe aktualisht eshte duke u hetuar nga organi i akuzes ne kuader te procedimit penal 2226/2016.

**Gjykata** pasi mori ne shqyrtim kerkesen ne raport me dispozitat procedurale penale dhe provat e lejuara per shqyrtim vendos pranimin e saj si te bazuar ne ligj.

Neni 274 dhe 276 te KPrP sanksionojne:

*"Kur ka rrezk qe disponimi i lire i nje sendi qe lidhet me vepren penale mund te rendoje ose zjase pasojat e saj ose te lehtesoje kryerjen e veprave te tjera penale me kerkesen e prokurorit gjykata kompetente urdheron sekuestrimin e tyre me vendim te arsyetuar.*

2. Sekuestroja mund te vendoset edhe per sendet, produktet e vepres penale dhe cdo lloj pasurie tjeter qe lejohet te konfiskohet sipas nenit 36 te Kodit Penal.

3. Kur ndryshojne kushtet e zbatimit gjykata me kerkese te prokurorit ose te interesuarit e heq sekuestron ( neni 274)

*“1. Kunder vendimit per venien ose mosvenien e sekuestror cildo qe ka interes mund te beje ankim.*

*2. Kerkesa e ankimit mund te paraqitet brenda 10 diteve nga dhenia e vendimit ose nga dita kur i interesuari ka marre dizeni per sekuestron e vene....”*

Sekuestro preventive eshte mase sigurimi pasurore qe aplikohet ne rastet kur ka arsye te dyshohet se disponimi i lire i nje sendi qe lidhet me vepren penale rendon ose zjat pasojat e saj ose mund te lehtesoje kryerjen e veprave te tjera penale. Vendosja e sekuestror ne kete rast pengon perdorimin dhe qarkullimin e lire te sendeve qe lidhen me vepren penale duke garantuar ne kete menyre nevojat e sigurimit. Sekuestrimi vendoset mbi cdo lloj pasurie qe lejohet te konfiskohet ne baze te nenit 36 te Kodit Penal ku perfshihen dhe produktet e vepres penale ( *Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka te beje me marrjen dhe kalimin ne favor te shtetit b) te produkteve te vepres penale, ku perfshihet cdo lloj pasurie....)*

Nga provat e nenshtruara shqyrtimit gjyqesor rezulton se organi i akuzes ka rregjistruar procedimin penale 2226/2016 per vepren penale te “ *Pastrimit te produkteve te vepres penale*” dhe ekzistojne prova te mjaftueshme per te krijuar dyshimin e arsyeshem ne lidhje me konsumimin e kesaj vepre penale nga ana e ortakeve te shoqerise S... A... sh.p.k.

Nga te dhenat e siguruara nga organi i akuzes rezulton se subjekti S... A... sh.p.k, i cili ushtron aktivitetet ne fushen e tregtimit te arit disponon llogari te konsiderueshme bankare prane Tirana Bank sha, te cilat nuk justifikohen nga pikepamja ekonomike pasi sasia e konsiderueshme e vlerave monetare nuk mbulohet nga burime te ligjshme financiare. Dyshimet bazohen dhe ne shpeshesine e transfertave bankare brenda nje periudhe te shkurter kohore, te cilat per tre muaj arrijne ne shumen 561 644 euro prane Tirana Bank sh.a. Njekohesisht nga informacionet e marra nga autoritetet italiane ekzistojne te dhena se ortaket e kesaj shoqerie jane te perfshire ne aktivite kriminale ne Itali.

Duke marre ne konsiderate indiciet e autoriteteve homologe policore mbi perfshirjen ne aktivite kriminale ne Itali te ortakeve te shoqerise S... A... sh.p.k, shumat e konsiderueshem monetare te disponuara nga ky subjekt tregetar ne llogarite prane Tirana Bank sha, per te cilat ekzistojne dyshime, qe do ti nenshtrohen me pas hetimit te thelluar penal, se nuk justifikohen nga aktiviteti tregetar, transaksionet e shpeshta bankare dhe me subjekte jashte territorit te

RSH krijohet dyshimi i arsyeshem dhe i bazuar ne prova se burimi i pasurise se shoqerise S... A... sh.p.k jane te ardhurat e siguruara nga aktivite kriminale.

Ne keto kushte gjykata vlereson se eshte e nevojshme te zbatohet masa e sigurimit “ sekuestro preventive “ mbi llogarine bankare te shoqerise S... A... sh.p.k ( NIPT L52... T) prane Tirana Bank sh.a dhe ne cdo banke te nivelit te dyte ne RSH ne baze te nenit 274 te KPrP. Kjo mase cmohet e nevojshme per te shmanguar qarkullimin e metejshem te produkteve te dyshuara te veprave penale, te cilat rrezikojne te rendojne dhe zjasin pasojat e saj.

### **PER KETO ARSYE**

Mbeshtetur ne nenin 274 te K Pr Penale, gjykata

### **V E N D O S I**

- 1.Pranimin e kerkeses.
2. Vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarite ne leke dhe euro te shoqerise S... A... sh.p.k ( NIPT L5... T) prane Tirana Bank sh.a dhe mbi te gjitha llogarite e ketij subjekti ne bankat e nivelit te dyte ne RSH.
- 3.Ngarkohen oficeret e policise gjyqesore per ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi.
- 4.Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 10 diteve nga shpallja e vendimit.Per subjektet e interesuara ky afat fillon nga dita e venies ne dijeni te sekuestros.

**U shpall ne Tirane date 21.04.2016**

**S E K R E T A R E**

**G J Y Q T A R E**

**DILA DOÇI**

**ANTONELA PRENDI**